



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA
MINISTËR SHTETI PËR PUSHTETIN VENDOR
AGJENCIA PËR MBËSHTETJEN E VETËQEVERISJES VENDORE

PROCESVERBALI I MBLEDHJES

**TAKIMI ME GRUPIN E PUNËS PËR MIRATIMIN E TREGUESVE TË PROPOZUAR
TË SISTEMIT TË MATJES SË PERFORMANCËS 2024**

Tiranë, 17 Qershor 2025

Hapja e mbledhjes

Në zbatim të hartimit të raportit të performancës të Njërive të Vetëqeverisjes Vendore për vitin 2024, u mbajt mbledhja për miratimin e treguesve të performancës 2024 më 17.06.2025 në ambientet e Kryeministrit.

Takimi u hap nga Z. Arbjan Mazniku, Ministër i Shtetit për Pushtetin Vendor, i cili falenderoi pjesëmarrësit për angazhimin e tyre. Bashkitë konsiderohen përfituesit kryesorë, pasi ky sistem ndihmon në identifikimin e pozicionit të tyre dhe vendimeve që duhet të ndërmarrin për përmirësimin e shërbimeve publike, duke i dhënë një nxitje të re pune dhe duke i fokusuar përpjekjet qeveritare në problematikat që prekin të gjitha bashkitë njëkohësisht.

Z. Mazniku u shpreh se ngritja e këtij procesi ka qenë një ushtrim i mundimshëm, por shumë i dobishëm, duke vënë theksin tek rezultatet pozitive që ai ka sjellë. Ai theksoi rëndësinë që ky proces të institucionalizohet si një praktikë më e qëndrueshme dhe sistematike, me një periodicitet vjetor. Gjithashtu, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, është nisur diskutimi për kthimin e disa treguesve në indikatorë që sigurojnë financim për bashkitë, përmes një projekti pilot, siç është Granti i Bazuar në Performancë.

Nga ana e Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore është realizuar një vlerësim lidhur me strukturimin e disa treguesve. Ndryshe nga SMP 2023, ku treguesit u krijuan për herë të parë dhe puna ishte intensive, në SMP 2024 puna është më e thjeshtë si pasojë e përvojës së fituar gjatë vitit të kaluar. Në këtë kuadër, janë paraqitur sugjerime për ndryshime në treguesit ekzistues dhe propozime për tregues të rinj. Sistemi është tashmë i ngritur dhe puna e Grupit Ndërinstitucional të Punës (GNP) është më e përqendruar, duke mbetur brenda kuadrit të detyrave administrative midis agjencisë dhe bashkive.

Pas fjalës së tij ministri, Z. Arbjan Mazniku ia dorëzoi fjalën Z. Stiljan Llavdaniti, Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar i Agjencisë për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore për prezantimin e treguesve të SMP 2024.

Çështje të diskutuara

Z. Stiljan Llavdaniti prezantoi projekt-propozimin lidhur me SMP 2024. Ai theksoi se për përgatitjen e këtij propozimi janë zhvilluar gjashtë takime me Grupin Teknik të Punës, të strukturuar sipas fushave dhe me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të ministrive përkatëse dhe ekspertëve nga projekti “Bashkitë të Forta”. Këto takime u fokusuan në fushat e arsimit, mirëqeverisjes, bujqësisë, mjedisit, projekteve dhe mbrojtjes sociale. Gjatë prezantimit, Z. Llavdaniti evidentoi 52 tregues, pjesë e projekt-propozimit, nga të cilët 31 tregues mbeten të pandryshuar nga SMP 2023, ndërsa 21 tregues janë propozuar për t’u përfshirë për herë të parë në këtë skemë, prej të cilëve 5 tregues bëjnë pjesë në GBP. Ai vijoi me prezantimin e detajuar për çdo fushë dhe treguesit përkatës që lidhen me to.

Komente

Znj. Erjona Çela, Zv. Ministër. Ministria e Financave shfaqti interes lidhur me arsyen e vendosjes së treguesit të fushës së bujqësisë që lidhet me mirëmbajtjen e kanaleve të ujitjes dhe kullimit. Ajo kërkoi të sqarojë nëse ky tregues është vendosur për shkak të mungesës së monitorimit apo për shkak të mungesës së efikasitetit.

Z. Llavdaniti iu përgjigj duke sqaruar se ky tregues është vendosur pasi përfaqësuesit e Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (MBZHR) kanë theksuar se nuk përputhet regjistri i vjetër i kanaleve me regjistrin faktik. Kjo ka sjellë paraqitjen e kilometrave të ndryshme të kanaleve që bashkëtohen në menaxhim, për shkak të ndryshimeve klimatike, zhvillimeve urbane dhe erozionit. Si rezultat, edhe matja e tyre ka rezultuar e pasaktë. Sipas të dhënave të raportuara, rrjeti i kanaleve ujëtare është vlerësuar në 25,000 km nga MBZHR, ndërkohë që nga bashkëtohen ky tregues është raportuar në vlerën e 16,778 km.

Z. Mazniku theksoi se edhe gjatë zbatimit të SMP 2023, ky tregues ka rezultuar problematik në raportim, për shkak të përqindjeve të ndryshme të raportuara nga bashkëtohen. Ai sqaroi se në disa bashki është raportuar arritja e nivelit maksimal në menaxhim, ndërsa në bashki të tjera ky tregues është raportuar në nivelin minimal.

Znj. Bukurie Çika, Specialist, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural u shpreh se këto kanale janë të regjistruara si pronë në Ministri. Ajo sqaroi se ndërtimet e ndryshme të zhvilluara gjatë viteve të fundit, si dhe transformimi i zonave të ujitjes dhe i zonave rurale, kanë sjellë krijimin e kësaj difference në të dhëna.

Z. Fran Brahimi, Drejtor i Financave Vendore, Ministria e Financave u shpreh se treguesit duhet të vlerësohen me një metodologji të përshtatshme, e cila synon përmirësimin e raportit dhe mënyrën e vlerësimit të tyre. Ai theksoi rëndësinë e kthimit të këtij raporti në një mjet që konsultohet dhe përdoret gjerësisht nga qytetarët, dhe jo vetëm nga personat që e kanë përgatitur atë. *Z. Brahimi* u ndal veçanërisht tek fusha e mirëqeverisjes, duke përmendur treguesin “Publikimi i PBA 2024-2026 në faqen zyrtare të bashkisë”. Ai sqaroi se ky tregues është i disponueshëm në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe mund të aksesohet më së miri aty, duke siguruar transparencë dhe akses të lehtë për publikun.

Z. Mazniku u shpreh se pavarësisht që PBA ndodhet në faqën e Ministrisë së Financave, përdoruesit kryesorë mund të jenë punonjësit e administratës, ndërsa qytetarët fillimisht e aksesojnë materialin në faqen zyrtare të bashkisë.

Znj. Valbona Karakaçi, Këshilltare, HELVETAS u shpreh se është e cituar në ligj që PBA duhet të jetë e publikuar në faqen zyrtare të bashkisë.

Z. Llavdaniti theksoi se ky tregues lidhet ngushtë me kriteret e transparencës, ku një nga kushtet kryesore është publikimi i këtij raporti në faqen web të bashkisë. Ai shtoi se kjo praktikë është në përputhje dhe për afrim me kriteret evropiane për transparencë dhe qeverisje të mirë.

Z. Mazniku u ndal tek treguesi i barazisë gjinore “Përqindja e buxhetit vendor të alokuar për nisma që mbështesin barazinë gjinore në secilin program buxhetor vendor”, duke e cilësuar atë si një tregues të pamatshëm dhe të vështirë për t’u matur. Ai theksoi se fillimisht duhet të shpjegohet mirë ky tregues për zyrtarët buxhetorë të bashkive, edhe pse ky është një detyrim ligjor prej vitesh. Ky tregues paraqet vështirësi pasi nisur edhe nga eksperiencia e ndarjes së buxhetit në kapital, operativ dhe pagat, si dhe ndarjes së aparatit administrativ nga pjesa tjetër e strukturës së bashkisë (shërbimet), stafi i bashkive do të ketë vështirësi në identifikimin dhe raportimin e saktë të këtij treguesi.

Znj. Erjona Çela u shpreh se edhe ministria e ka të vështirë identifikimin e këtij treguesi mes zërave buxhetorë.

Z. Brahimi u shpreh se bashkitë e mbështetura me projekte kanë shumë të specifikuar dhe të zhvilluar ndarjen e fondit për nisma gjinore në buxhetin e tyre. Gjithashtu, ai theksoi gjatë diskutimeve rëndësinë e përfshirjes së treguesve lidhur me ndryshimet klimatike, duke e konsideruar këtë si një risi dhe një temë shumë të ndjeshme për SMP-në e viteve të ardhshme.

Z. Mazniku u shpreh se, pavarësisht faktit që disa bashki kanë ndarë këtë zë buxhetor në mënyrë të detajuar, ka edhe bashki të tjera që nuk e kanë bërë këtë, duke e bërë treguesin jo të unifikuar dhe jo të zbatueshëm në mënyrë horizontale në të gjitha bashkitë. Ai theksoi gjithashtu se, nga ana parimore, nuk e sheh të arsyeshme përfshirjen e këtij treguesi, pasi ekzistojnë edhe kategori të tjera nismash që mund të përfshihen, si ato që lidhen me moshën e tretë, mbështetjen e rinisë etj. Sipas tij, ndarja e buxhetit në këtë mënyrë krijon shumë nënkategori, çka e ndërlikon procesin e vlerësimit dhe raportimit.

Znj. Karakaçi shpjegoi se në ligjin e financave vendore, ky tregues përkufizohet si “Numri i programeve të ndjeshme nga pikëpamja e barazisë gjinore” dhe janë shtatë tregues të cilët monitorohen nga ky ligj. Në këtë mënyrë, treguesi është lehtësisht i matshëm, pasi mund të përcaktohet nëse një program ka tregues të ndjeshëm ndaj barazisë gjinore apo jo, dhe nëse ka, ato maten. Ajo dha shembullin e fushës së bujqësisë, duke sqaruar se ligji nuk përcakton që çdo program duhet të jetë domosdoshmërisht nga pikëpamja gjinore. Megjithatë, mund të ketë një zë buxhetor me titullin “gra të angazhuara për zhvillimin rural” ose “numri i grave përfituese nga Granti”.

Znj. Nertila Topulli, Drejtor i Përkujdesit dhe Shërbimeve Sociale, MSHMS u shpreh se ekzistojnë disa programe sensitive nga pikëpamja gjinore, të cilat janë gjithashtu subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit. Ajo deklaroi gatishmërinë për t’i vendosur këto materiale në dispozicion sa më shpejt të jetë e mundur.

Z. Mazniku rimori sërish temën e treguesit të barazisë gjinore, duke theksuar nevojën për identifikimin e programeve dhe verifikimin nëse ato janë të përcaktuara në planin e zhvillimit ekonomik. Ai shprehu shqetësimin lidhur me mënyrën se si ky tregues mund të interpretohet në momentin e publikimit, duke nënvizuar rëndësinë e qartësisë dhe saktësisë në raportim.

Znj. Topulli u ndal në treguesin “Numri i rasteve të trajtuara kundrejt rasteve të raportuara të dhunës në familje” duke shprehur pikëpyetje lidhur me konceptin e trajtimit, nëse këto raste trajtohen me ndihmë ekonomike, shërbime sociale apo në mënyra të tjera.

Z. Llavdaniti sqaroi se ky tregues i referohet përfshirjes së këtyre rasteve në sistemin e raportimit. Ai theksoi se në momentin që një grua paraqitet pranë institucionit për raportimin e dhunës dhe ky raportim vazhdon me përfshirjen e policisë, urdhrin e mbrojtjes etj, rastet konsiderohen të trajtuara në kuptimin e këtij treguesi. Ky tregues është propozuar nga eksperti i UN Women.

Znj. Topulli gjithashtu u ndal tek treguesi “Përqindja e personave me aftësi të kufizuar, të referuar nga komisionet bio-psiko-sociale që marrin mbështetje sociale”, duke pyetur nëse ky tregues i referohet pagesave sociale apo shërbimeve sociale. Ajo sqaroi se komisioni bio-psiko-social është ai që legjitimon marrjen e pagesës së aftësisë së kufizuar, por njëkohësisht në formularin përkatës mund të përcaktohet edhe referimi për marrjen e shërbimeve sociale. *Znj. Topulli* theksoi se shumë bashki nuk kanë shërbime sociale, gjë që mund t’i vendosë ato në një pozitë të vështirë për raportimin e këtij treguesi. Për këtë arsye, ajo propozoi që ky tregues të marrë formën e treguesit të ndihmës ekonomike, i cili mat vetëm përfitimin me pagesë të Personave me Aftësi të Kufizuar. Në këtë mënyrë, treguesi do të ishte “Përqindja e aplikuesve PAK kundrejt përfituesve”, duke u fokusuar në përfituesit e pagesës dhe duke shmangur vështirësitë që lidhen me mungesën e shërbimeve sociale në disa bashki.

Z. Llavdaniti u shpreh se në këtë tregues përfshihen shërbimet që bashkia ofron për kategoritë në fjalë. Ai theksoi se treguesit janë të hapur ndaj komenteve dhe ndryshimeve, duke theksuar se ky propozim ka ardhur nga përfaqësues të MSHMS.

Z. Erton Kashta, Oficer Programi, HELVETAS u shpreh se ligjërisht bashkitë duhet të ofrojnë shërbime sociale, që lidhen me konceptin e mbështetjes sociale, dhe këto shërbime duhet të jenë pjesë e paketës së shërbimeve që bashkia ofron. Qëllimi i këtij treguesi është të bëhet krahasimi midis bashkive për të identifikuar se cilat prej tyre ofrojnë këto shërbime dhe cilat jo.

Znj. Topulli u shpreh për treguesin e ndihmës ekonomike, duke sugjeruar që formulimi i tij të jetë më i përshtatshëm, për shembull: “Përqindja e personave përfitues të ndihmës ekonomike, referuar në tregun e punës për punësim ose formim profesional”. Sa i përket PAK, problemi kryesor lidhet me aksesueshmërinë, të cilën bashkitë kanë vështirësi në realizimin e saj. Termi “mbështetje” nuk është i përcaktuar qartë dhe nuk specifikon se çfarë lloji mbështetjeje përfitojnë personat me aftësi të kufizuar, gjë që krijon paqartësi në matjen dhe vlerësimin e ndihmës së ofruar nga bashkitë.

Znj. Karakaçi u shpreh se këto specifikime dhe informacione do të jenë pjesë e pasaportës së treguesit që do të gjendet në manualin e SMP.

Znj. Topulli u ndal tek treguesi “Numri i qendrave sociale komunitare për 10,000 banorë”, i cili lidhet me licencimin e këtyre qendrave dhe kategoritë që përfshihen, të përcaktuara në ligj, duke kërkuar një shpjegim më të detajuar nga *Z. Llavdaniti*.

Z. Enkelejd Musabelliu, Zv/Ministër, MEKI komentoi lidhur me fushën e arsimit, duke u fokusuar më konkretisht te forcimi i kapaciteteve në sistemin parashkollor, veçanërisht numri i fëmijëve dhe vendet e disponueshme në çerdhe dhe kopshte, duke i krahasuar ato me të dhënat e gjendjes civile. Ai theksoi se mungojnë të dhëna të detajuara për kapacitetet arsimore që kanë bashkitë në sistemin parauniversitar. Po ashtu, ai sugjeroi që në shërbimet sociale të fokusohet në kapacitetin e ofrimit të këtyre shërbimeve për të gjitha kategoritë, duke krijuar një hartëzim të ofertës që bashkitë kanë në dispozicion për shërbimet sociale.

Z. Mazniku u shpreh se rëndësia e këtyre treguesve qëndron në faktin që ata janë tregues performancë dhe jo thjesht tregues të thjeshtë. Ai theksoi se si tregues performancë, këta tregues mund të matën në kohë dhe të krahasohen nga viti në vit, duke mundësuar një vlerësim më të saktë dhe të vazhdueshëm.

Z. Aldo Merkoçi, Këshilltar, Ministria e Shtetit për Pushtetin Vendor shpjegoi se ideja është që treguesit të jenë të krahasueshëm mes bashkive dhe në kohë. Pas kësaj, mund të ketë hapësira për të shtuar ide në fusha të ndryshme, por nëse ngarkohet ky raport mund të mos jetë lehtësisht i matshëm dhe dhe në kohë dhe më njëri-tjetrin.

Z. Musabelliu theksoi se ky ushtrim i shërben dy qëllimeve kryesore: së pari, krijimin e treguesve të matshëm për të pasur një bazë të qëndrueshme të të dhënave; dhe së dyti, detyron bashkitë të zhvillojnë një sistem statistikash bazuar në kërkesë. Kjo nxit bashkitë që të prodhojnë tregues që mund t’i përdorin në punën e tyre të përditshme, ndërsa siguron që të gjithë donatorët dhe aktorët e interesit të kenë akses në këto të dhëna.

Z. Mazniku mbylli mbledhjen duke përmendur se procesi i miratimit të treguesve do të jetë i hapur për komentet edhe për pak kohë dhe ftoi ministrinë e linjës të japin sugjerimet e tyre. Ai njoftoi se ky ushtrim është planifikuar të përfundojë në fund të vjeshtës.

Përfundime

Në përfundim të takimit u dakordësuan treguesit e performancës me Grupin Ndërinstitucional të Punës, me përjashtim të treguesve të Mbrojtjes Sociale dhe Barazisë Gjinore, nga të cilat priten sugjerimet nga MSHMS për t’u finalizuar lista e treguesve të SMP 2024.

